



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE TATIMORE DHE KONTABILITETIT

Nr.15693 Prot.

Tiranë, më 11. 5. 2015

Lënda: Rregullat për deklarimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe TAP, të periudhave tatimore të mëparshme.

Drejtuar: Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore _____

Për dijeni: Drejtorisë Shërbimit dhe Regjistrimit të Tatimpaguesve
Drejtorisë Auditit të Brendshëm
Drejtorisë Kontrollit Tatimor
Drejtorisë Teknike
Drejtorisë Teknologjisë së Informacionit
Drejtorisë Ligjore
Drejtorisë Mbledhjes së Borxhit
Drejtorisë Menaxhimit të Riskut
Drejtorisë Hetimit Tatimor
Drejtorisë Apelimt Tatimor
Drejtorisë Avokatit të Tatimpaguesve
Drejtorisë Administratës dhe Prokurimeve

Rastet e vetëdeklarimeve apo rivlerësimeve për deklarimin e kontributeve shtesë të periudhave tatimore të mëparshme, janë ato që lidhen me diferenca në numrin e punëmarësve ose pagave të tyre të periudhave tatimore përkatëse.

Mundësitë e rivlerësimeve dhe vetëdeklarimeve për kontribute shtesë lidhen dhe pasqyrohen me diferenca në deklarimin e: a) numrit të punëmarësve, b) pagave të punëmarësve, c) numrit të punëmarësve dhe pagave të tyre.

Për të unifikuar veprimet lidhur me deklarimin dhe pagimin e shtesave të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të periudhave tatimore të mëparshme, që kanë lidhje me zbatimin e një akti zyrtar, i cili depozitohet në Drejtorinë Rajonale Tatimore, të zbatohen rregullat dhe procedurat si më poshtë:

A) Për periudhat tatimore të mëparshme deri në periudhën tatimore janar 2012 në të cilat listëpagesat dorëzohen në formë shkresore:

1) Me kërkesën zyrtare për drejtorinë rajonale tatimore për pagimin e kontributeve shtesë tatimpaguesi dërgon edhe vendimin/vendimet e gjykatës mbi bazën e të cilit do të paguhen kontribute shtesë dhe tatim mbi ardhurat nga punësimi të periudhave tatimore të mëparshme.

2) Bashkë me kërkesën tatimpaguesi dërgon zyrtarisht në Drejtorinë Rajonale Tatimore, listëpagesë, në formë shkresore, sipas periudhave tatimore të mëparshme, të plotësuar me të dhënat për pagat dhe kontributet shtesë të personave përkatës. Këto listëpagesa tatimpaguesi i plotëson me të gjitha të dhënat e kërkuara sipas formatit të miratuar.

Këto janë listëpagesa shtesë të listëpagesave të periudhave tatimore përkatëse, të cilat tatimpaguesi i ka dorëzuar në Drejtorinë Rajonale Tatimore më përpara.

3) Në çdo listëpagesë shtesë, në fund të saj, nga tatimpaguesi bëhet shënimi shpjegues për bazën mbi të cilën janë llogaritur kontributet që ajo përmban, si p.sh.:

- "Listëpagesë shtesë e cila ka lidhje me zbatimin e Vendimit/Vendimeve të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor _____, Nr. _____, datë _____, kopja bashkëlidhur".

Çdo listëpagese shtesë i bashkëlidhet nga një fotokopje e aktit apo vendimit përkatës mbi bazën e të cilit janë llogaritur kontributet që ajo përmban.

4) Mbi bazën e të dhënave të listëpagesave shtesë të periudhave tatimore të mëparshme, të dorëzuara në drejtorinë rajonale tatimore, inspektori përkatës bën rivlerësimin e deklaratave të detyrimeve të kontributeve dhe të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, të periudhave tatimore përkatëse.

5) Pas rivlerësimit të situatës, tatimpaguesi printon urdhërpagesën nga llogaria e tij në sistemin informatik ose e merr atë nga drejtoria rajonale tatimore dhe bën pagimin e kontributeve dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi me shumat përkatëse.

6) Vetëm pas pagimit të plotë të shumës të kontributeve, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, drejtoria rajonale tatimore dërgon zyrtarisht listëpagesën në organet e sigurimeve shoqërore të rajonit përkatës.

7) Drejtoria rajonale tatimore administron vendimet e gjykatës, mbi bazën e të cilave janë hartuar listëpagesat shtesë të periudhave tatimore përkatëse për kontributet të periudhave tatimore të mëparshme, së bashku me nga një kopje të këtyre listëpagesave.

8) I gjithë dokumentacioni i dërguar nga tatimpaguesi, si përmendet më sipër, ngarkohet (regjistrohet) në sistemin informatik nga inspektori përkatës së bashku me dokumentacionin që ai përpilon në çështjen e hapur në sistem për korrigjim të situatës.

B) Për periudhat tatimore pas dhjetorit 2011 deri në periudhën e implementimit të sistemit të ri tatimor C@TS:

1) Me kërkesën zyrtare për drejtorinë rajonale tatimore për pagimin e kontributeve shtesë dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi shtesë tatimpaguesi dërgon edhe vendimin/vendimet e gjykatës mbi bazën e të cilit do të paguhen kontributet dhe tatimi mbi të ardhurat nga punësimi të periudhave tatimore të mëparshme.

2) Inspektori përkatës, në sistemin e deklarimit elektronik, mbi bazën e dokumentacionit përkatës të dërguar nga tatimpaguesi (listëpagesa shtesë, pasqyra e të punësuarve për herë të parë, atyre

rishtazi dhe e të larguarve nga puna) bën korigjimet ne pasqyrat përkatëse (ESIG 027, ESIG 025) sipas periudhave tatimore përkatëse, kryen rivlerësimin e deklaratave të detyrimeve të kontributeve dhe të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, të periudhave tatimore përkatëse.

3) Në çdo listëpagesë, në fund të saj, nga inspektori bëhet shënimi shpjegues për bazën mbi të cilën janë llogaritur kontributet që ajo përmban, si p.sh.:

- "Listëpagesë shtesë e cila ka lidhje me zbatimin e Vendimit/Vendimeve të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor _____, Nr. _____, datë _____, kopja bashkëlidhur".

4) Pas rivlerësimit të situatës në sistemin informatik tatimpaguesi printon urdhërpagesën nga llogaria e tij në sistemin informatik ose e merr atë në DRT-në përkatëse dhe bën pagesat për detyrimet shtesë të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe TAP.

5) Vetëm pas pagimit të plotë të shumës së kontributeve, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, drejtoria rajonale tatimore dërgon elektronikisht listëpagesën në organet e sigurimeve shoqërore të rajonit përkatës.

6) Drejtoria rajonale tatimore administron vendimet e gjykatës, mbi bazën e të cilave janë hartuar listëpagesat shtesë të periudhave tatimore përkatëse për kontributet të periudhave tatimore të mëparshme, së bashku me nga një kopje të këtyre listëpagesave.

7) I gjithë dokumentacioni i dërguar nga tatimpaguesi, si përmendet më sipër, ngarkohet (regjistrohet) në sistemin informatik nga inspektori përkatës së bashku me dokumentacionin që ai përpilon në çështjen e hapur në sistem për korigjim të situatës.

C) Për periudhat tatimore pas implementimit të sistemit të ri tatimor C@TS:

1) Tatimpaguesi, brenda periudhës që i lejohet korigjimi deklaron në formë elektronike të dhënat e listëpagesës për kontributet e personave për të cilët do të paguhen kontribute shtesë dhe tatim mbi të ardhurat nga punësimi shtesë ndaj periudhave tatimore përkatëse, ndërsa për periudhat e tjera i dërgon në formë kërkesë në drejtorinë rajonale tatimore përkatëse me të gjitha dokumentat e domosdoshme për vlerësim në mënyrë se procedura të kryhet nga inspektori tatimor.

2) Në çdo listëpagesë, në vendin e caktuar, tatimpaguesi bën shënimin për arsyen përse ajo është deklaruar, si p.sh.:

- "Listëpagesë e cila ka lidhje me zbatimin e Vendimit/Vendimeve të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor _____, Nr. _____, datë _____".

3) Pas vlerësimit të situatës në sistemin informatik tatimpaguesi printon urdhërpagesën nga llogaria e tij në sistemin informatik dhe bën pagesat për detyrimet shtesë të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi.

4) Vetëm pas pagimit të plotë të shumës së kontributeve, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, drejtoria rajonale tatimore dërgon elektronikisht listëpagesën në organet e sigurimeve shoqërore të rajonit përkatës.

5) Drejtoria rajonale tatimore administron vendimet e gjykatës, mbi bazën e të cilave janë hartuar listëpagesat shtesë të periudhave tatimore të mëparshme për kontributet të periudhave tatimore të mëparshme, së bashku me nga një kopje të printuar të këtyre listëpagesave.

Drejtoria e Shërbimit dhe Regjistrimit të Tatimpaguesve të marrë masa për publikimin e kësaj shkrese në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve www.tatime.gov.al , në rubrikën e vendimeve teknike për kontributet.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

BRISIDA SHEHAJ

